18.2. Pushimin e akuzës në ngarkim të të pandehurit **Ylli Çaushaj**, për kryerjen e veprës penale "*Falsifikimi i dokumentave*", e kryer në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga neni 186/1 dhe 28/4 i Kodit Penal, për shkak se ndjekja penale nuk duhet të vazhdojë për këtë veprë penale.

18.3. Bazuar në nenin 55 të Kodit Penal, në bashkim të dënimeve i pandehuri **Ylli Çaushaj** dënohet me një dënim të vetëm prej **11 (njëmbëdhjetë) vjet burgim**.

18.4. Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit **Ylli Çaushaj** i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me **7 (shtatë) vjet e 4 (katër) muaj burgim**.

18.5. Vuajtja e dënimit për pjesën e pavuajtur të kryhet nga i pandehuri **Ylli Çaushaj**, në një burg të sigurisë së lartë, në respektim të nenit 16 pika 1, gërma "a" të Ligjit Nr. 81/2020 "*Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve*".

19. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Artid Shtylla**, për kryerjen e veprës penale "*Falsifikimi i dokumentave*", e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me **2 (dy) vjet e 6 (gjashtë) muaj burgim**.

19.1. Pushimin e akuzës në ngarkim të të pandehurit **Artid Shtylla**, për kryerjen e veprës penale "*Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive*", parashikuar nga neni 280 i Kodit Penal, për shkak se vepra penale është shuar me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 57, viti 2026 "*Për dhënie amnistie*".

19.2. Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit **Artid Shtylla** i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me **1 (një) vit e 8 (tetë) muaj burgim**.

20. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Murat Gjuniku**, për kryerjen e veprës penale "*Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve*", me qëllim përfitimi, e kryer në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal, "*Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal*", parashikuar nga neni 298 paragrafi 2, dhe në lidhje me nenet 28/4 dhe 334/1 të Kodit Penal, dënimin e tij me **8 (tetë) vjet burgim**.

20.1. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Murat Gjuniku**, për veprën penale "*Grupi i strukturuar kriminal*", parashikuar nga neni 333/a/2 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me **2 (dy) vjet burgim**.

20.2. Pushimin e akuzës në ngarkim të të pandehurit **Murat Gjuniku**, për kryerjen e veprës penale "*Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave*", e kryer në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga neni 189/1 dhe 28/4 i Kodit Penal, për shkak se ndjekja penale nuk duhet të vazhdojë për këtë vepër penale.

20.3. Bazuar në nenin 55 të Kodit Penal, në bashkim të dënimeve i pandehuri **Murat Gjuniku** dënohet me një dënim të vetëm prej **8 (tetë) vjet burgim**.

20.4. Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit **Murat Gjuniku** i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me **5 (pesë) vjet e 4 (katër) muaj burgim**.

20.5. Vuajtja e dënimit për pjesën e pavuajtur të kryhet nga i pandehuri **Murat Gjuniku**, në një burg të sigurisë së lartë, në respektim të nenit 16 pika 1, gërma "a" të Ligjit Nr. 81/2020 "*Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve*".

21. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Bardhyl Imeri**, për kryerjen e veprës penale "*Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve*", me qëllim përfitimi, e kryer në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal, "*Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal*", parashikuar nga neni 298 paragrafi 2, dhe në lidhje me nenet 28/4 dhe 334/1 të Kodit Penal, dënimin e tij me **8 (tetë) vjet burgim**.

21.1. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Bardhyl Imeri**, për veprën penale "*Grupi i strukturuar kriminal*", parashikuar nga neni 333/a/2 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me **2 (dy) vjet burgim**.

21.2. Pushimin e akuzës në ngarkim të të pandehurit **Bardhyl Imeri**, për kryerjen e veprës penale "*Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave*", e kryer në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga neni 189/1 dhe 28/4 i Kodit Penal, për shkak se ndjekja penale nuk duhet të vazhdojë për këtë vepër penale.

21.3. Pushimin e akuzës në ngarkim të të pandehurit **Bardhyl Imeri**, për kryerjen e veprës penale "*Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive*", parashikuar nga neni 280 i Kodit Penal, për shkak se vepra penale është shuar me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 57, viti 2026 "*Për dhënie amnistie*".

21.4. Bazuar në nenin 55 të Kodit Penal, në bashkim të dënimeve i pandehuri **Bardhyl Imeri** dënohet me një dënim të vetëm prej **8 (tetë) vjet burgim**.

21.5. Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit **Bardhyl Imeri** i ulet 1/3 (*një e treta*) e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me **5 (pesë) vjet e 4 (katër) muaj burgim**.

21.6. Vuajtja e dënimit për pjesën e pavuajtur të kryhet nga i pandehuri **Bardhyl Imeri**, në një burg të sigurisë së lartë, në respektim të nenit 16 pika 1, gërma "a" të Ligjit Nr. 81/2020 "*Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve*".

22. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Bajram Xhaja**, për kryerjen e veprës penale "*Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve*", me qëllim përfitimi, e kryer në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal, "*Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal*", parashikuar nga neni 298 paragrafi 2, dhe në lidhje me nenet 28/4 dhe 334/1 të Kodit Penal, dënimin e tij me **9 (nëntë) vjet burgim**.

22.1. Pushimin e akuzës në ngarkim të të pandehurit **Bajram Xhaja**, për kryerjen e veprës penale "*Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave*", e kryer në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga neni 189/1 dhe 28/4 i Kodit Penal, për shkak se ndjekja penale nuk duhet të vazhdojë për këtë vepër penale.

22.2. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Bajram Xhaja**, për veprën penale "*Grupi i strukturuar kriminal*", parashikuar nga neni 333/a/2 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me **2 (dy) vjet burgim**.

22.3. Bazuar në nenin 55 të Kodit Penal, në bashkim të dënimeve i pandehuri **Bajram Xhaja** dënohet me një dënim të vetëm prej **9 (nëntë) vjet burgim**.

22.4. Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit **Bajram Xhaja** i ulet 1/3 (*një e treta*) e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me **6 (gjashtë) vjet burgim**.

22.5. Vuajtja e dënimit për pjesën e pavuajtur të kryhet nga i pandehuri **Bajram Xhaja**, në një burg të sigurisë së lartë, në respektim të nenit 16 pika 1, gërma "a" të Ligjit Nr. 81/2020 "*Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve*".

23. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Besnik Lumaj**, për kryerjen e veprës penale "*Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve*", me qëllim përfitimi, e kryer në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal, "*Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal*", parashikuar nga neni 298 paragrafi 2, dhe në lidhje me nenet 28/4 dhe 334/1 të Kodit Penal, dënimin e tij me **8 (tetë) vjet burgim**.

23.1. Pushimin e akuzës në ngarkim të të pandehurit **Besnik Lumaj**, për kryerjen e veprës penale "*Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave*", e kryer në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga neni 189/1 dhe 28/4 i Kodit Penal, për shkak se ndjekja penale nuk duhet të vazhdojë për këtë vepër penale.

23.2. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Besnik Lumaj**, për veprën penale "*Grupi i strukturuar kriminal*", parashikuar nga neni 333/a/2 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me **2 (dy) vjet burgim**.

23.3. Bazuar në nenin 55 të Kodit Penal, në bashkim të dënimeve i pandehuri **Besnik Lumaj** dënohet me një dënim të vetëm prej **8 (tetë) vjet burgim**.

23.4. Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit **Besnik Lumaj** i ulet 1/3 (*një e treta*) e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me **5 (pesë) vjet e 4 (katër) muaj burgim**.

23.5. Vuajtja e dënimit për pjesën e pavuajtur të kryhet nga i pandehuri **Besnik Lumaj**, në një burg të sigurisë së lartë, në respektim të nenit 16 pika 1, gërma "a" të Ligjit Nr. 81/2020 "*Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve*".

24. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Altin Neli**, për kryerjen e veprës penale "*Falsifikimi i dokumentave*", e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me **3 (tre) vjet burgim**.

24.1. Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit **Altin Neli** i ulet 1/3 (*një e treta*) e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me **2 (dy) vjet burgim**.

24.2. Në aplikim të nenit 261 pika 1, gërma "c" të K.Pr.Penale, duke qenë se koha e paraburgimit është më e madhe se masa e dënimit të caktuar, urdhërohet shuarja e masës së sigurimit "*Arrest në shtëpi*", parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale, caktuar ndaj të pandehurit **Altin Neli** me vendimin Nr. 57, datë 09.06.2024, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

25. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Fatmir Stankova**, për kryerjen e veprës penale "*Falsifikimi i dokumentave*", e kryer në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga neni 186/1 dhe 28/4 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me **7 (shtatë) vjet burgim**.

25.1. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Fatmir Stankova**, për veprën penale "*Grupi i strukturuar kriminal*", parashikuar nga neni 333/a/2 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me **2 (dy) vjet burgim**.

25.2. Bazuar në nenin 55 të Kodit Penal, në bashkim të dënimeve i pandehuri **Fatmir Stankova** dënohet me një dënim të vetëm prej **7 (shtatë) vjet e 6 (gjashtë) muaj burgim**.

25.3. Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit **Fatmir Stankova** i ulet 1/3 (*një e treta*) e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me **5 (pesë) vjet burgim**.

25.4. Vuajtja e dënimit për pjesën e pavuajtur të kryhet nga i pandehuri **Fatmir Stankova**, në një burg të sigurisë së lartë, në respektim të nenit 16 pika 1, gërma "a" të Ligjit Nr. 81/2020 "*Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve*".

26. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Arben Rushiti**, për kryerjen e veprës penale "*Falsifikimi i dokumentave*", e kryer në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga neni 186/1 dhe 28/4 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me **7 (shtatë) vjet burgim**.

26.1. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Arben Rushiti**, për veprën penale "*Grupi i strukturuar kriminal*", parashikuar nga neni 333/a/2 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me **2 (dy) vjet burgim**.

26.2. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Arben Rushiti**, për kryerjen e veprës penale "*Falsifikimi i vulave, stampave ose formularëve*", parashikuar nga neni 190/1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me **3 (tre) vjet burgim**.

26.3. Bazuar në nenin 55 të Kodit Penal, në bashkim të dënimeve i pandehuri **Arben Rushiti** dënohet me një dënim të vetëm prej **8 (tetë) vjet burgim**.

26.4. Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit **Arben Rushiti** i ulet 1/3 (*një e treta*) e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me **5 (pesë) vjet e 4 (katër) muaj burgim**.

26.5. Vuajtja e dënimit për pjesën e pavuajtur të kryhet nga i pandehuri **Arben Rushiti**, në një burg të sigurisë së lartë, në respektim të nenit 16 pika 1, gërma "a" të Ligjit Nr. 81/2020 "*Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve*".

27. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Leonardo Lama**, për kryerjen e veprës penale "*Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave*", e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 189/2 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me **3 (tre) vjet burgim**.

27.1. Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit **Leonardo Lama** i ulet 1/3 (*një e treta*) e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me **2 (dy) vjet burgim**.

27.2. Vuajtja e dënimit për pjesën e pavuajtur të kryhet nga i pandehuri **Leonardo Lama**, në një burg të sigurisë së zakonshme.

28. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Xhelil Alla**, për kryerjen e veprës penale "*Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave*", e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 189/2 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me **4 (katër) vjet burgim**.

28.1. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Xhelil Alla**, për veprën penale "*Prodhimi i mjeteve për falsifikim të dokumenteve*", parashikuar nga neni 192 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me **1 (një) vit burgim**.

28.2. Bazuar në nenin 55 të Kodit Penal, në bashkim të dënimeve i pandehuri **Xhelil Alla** dënohet me një dënim të vetëm prej **4 (katër) vjet e 6 (gjashtë) muaj burgim**.

28.3. Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit **Xhelil Alla** i ulet 1/3 (*një e treta*) e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me **3 (tre) vjet burgim**.

28.4. Vuajtja e dënimit për pjesën e pavuajtur të kryhet nga i pandehuri **Xhelil Alla**, në një burg të sigurisë së zakonshme.

29. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Perlat Canaj**, për kryerjen e veprës penale "*Kultivimi i bimëve narkotike*", parashikuar nga neni 284/2 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me **5 (pesë) vjet burgim**.

29.1. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Perlat Canaj**, për kryerjen e veprës penale "*Prodhimi dhe shitja e narkotikëve*", parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me **7 (shtatë) vjet burgim**.

29.2. Bazuar në nenin 55 të Kodit Penal, në bashkim të dënimeve i pandehuri **Perlat Canaj** dënohet me një dënim të vetëm prej **7 (shtatë) vjet e 6 (gjashtë) muaj burgim**.

29.3. Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit **Perlat Canaj** i ulet 1/3 (*një e treta*) e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me **5 (pesë) vjet burgim**.

29.4. Vuajtja e dënimit për pjesën e pavuajtur të kryhet nga i pandehuri **Perlat Canaj**, në një burg të sigurisë së zakonshme.

30. Bazuar në nenet 190 dhe 391 të K.Pr.Penale, lidhur me provat materiale të sekuestruara në kuadër të këtij procedimi disponohet si më poshtë:

1) Sendet e sekuestruara të pandehurit Njazi Ademaj, konkretisht: i) shumat monetare prej 1.800 (një mijë e tetëqind) euro dhe 5.000 (pesë mijë) paund britanik, **të konfiskohen dhe të kalojnë në favor të shtetit; ii)** 1 (një) kartë identiteti austriake me numër *****, në emër të shtetasit W.N., i datëlindjes *****, e cila është **e falsifikuar, të asgjësohet; iii)** 1 (një) bllok shënimesh me kapak me ngjyrë blu, brenda të cilit ndodhen shënime të ndryshme numra telefoni, **të mbetet pjesë e dosjes; iv)** sendet e tjera të cilat përshkruhen në procesverbalin “Për sekuestrimin e sendeve” mbajtur më datë 07.06.2024 ora 11.00 **t’i kthehen të pandehurit Njazi Ademaj.**

2) Sendet e sekuestruara të pandehurit Ylli Brahimaj, që përshkruhen në procesverbalin “Për sekuestrimin e sendeve” mbajtur më datë 07.06.2024, **t’i kthehen këtij të pandehuri.**

3) Sendet e sekuestruara të pandehurit Rrezart Domi, konkretisht: i) telefonat celular dhe automjeti të cilët përshkruhen në procesverbalin “Për sekuestrimin e sendeve” mbajtur më datë 07.06.2024 ora 08:20 dhe në urdhrin “Për bashkimin e provave materiale me fashikullin gjyqësor” datë 31.07.2025, si dhe dokumentet: kartë banke “Intesa Sanpaolo” me numër *****; kartë banke “OTP Bank” me numër *****; kartë banke “OTP Bank” Gold me numër *****, në emër të të pandehurit Rrezart Domi; 1 peshore me bateri me një xham rrethor në pjesën e sipërme, me mbishkrim 5Kg/l KG; një mbështjellëse letre dhe skoci, tek e cila gjendeshin provat e lartë përmendura, **t’i kthehen këtij të pandehuri; ii)** Pasaportë Greke me numër serie *****; Pasaportë greke me numër serie *****; Karte Identiteti me numër ***** Greke; Kartë Identiteti me numër ***** Greke; Leje drejtimi me numër serie ***** Greke, që i përket shtetasit V.R i datëlindjes *****; Leje drejtimi me numër serie ***** Greke, që i përket shtetases R.V i datëlindjes *****; Leje drejtimi Polake në emrin e shtetasit M.D, me numër *****; Letër njoftim Polake në emrin e shtetasit M.D, me numër *****; dhe Pasaporte Polake në emrin e shtetasit M.D, me numër *****, të cilat janë të falsifikuara të asgjësohen; **iii)** Fletore me kapak me ngjyrë të verdhë dhe të bardhë; Një fletore me kapak me ngjyrë të kuqe; Një bllok me kapak me ngjyrë të kuqe; Një bllok me ngjyrë të kuqe me pika të bardha; Disa fletë formati (fletoreje dhe formati); Një bllok me ngjyrë kafe; Një fletore me kapak jeshil dhe të bardhë, si dhe një fotokopje pasaporte e shtetasit I.S me Nr pasaporte ***** së bashku me një fotokopje karte identiteti në gjuhën gjermane e këtij shtetasi me numër *****, **të mbeten pjesë e dosjes; iv)** sendet e tjera të cilat përshkruhen në procesverbalet “Për sekuestrimin e sendeve” mbajtur më datë 07.06.2024 dhe në urdhrin “Për bashkimin e provave materiale me fashikullin gjyqësor” datë 31.07.2025, **të konfiskohen dhe të kalojnë në favor të shtetit.**

4) Sendet e sekuestruara të pandehurit Osman Luca të cilat përshkruhen në procesverbalin “Për sekuestrimin e sendeve” mbajtur më datë 07.06.2024 ora 08:20 **t’i kthehen këtij të pandehuri.**

5) Sendet e sekuestruara të pandehurit Jugert Gashi të cilat përshkruhen në procesverbalin “Për sekuestrimin e sendeve” mbajtur më datë 07.06.2024 **t’i kthehen këtij të pandehuri.**

6) Sendet e sekuestruara të pandehurit Emiljan Marashi të cilat përshkruhen në procesverbalin “Për sekuestrimin e sendeve” mbajtur më datë 07.06.2024 **t’i kthehen këtij të**

pandehuri.

7) Sendet e sekuestruara të pandehurit Roland Islamaj të cilat përshkruhen në procesverbalin “Për sekuestrimin e sendeve” mbajtur më datë 07.06.2024 ora 11:00 **t’i kthehen këtij të pandehuri.**

8) Sendet e sekuestruara të pandehurit Gridi Elezi, konkretisht: i) telefoni celular i cili përshkruhet në procesverbalin “Për sekuestrimin e sendeve” mbajtur më datë 07.06.2024 ora 11:00 dhe në urdhrin “Për bashkimin e provave materiale me fashikullin gjyqësor” datë 31.07.2025, **ti kthehen këtij të pandehuri; ii)** 1 (një) copë qese plastike transparente me në brendësi pluhur të bardhë, me lëndë narkotike kokainë e cila pas peshimit rezultoi në peshën 2 gram, **të asgjesohet.**

9) Sendet e sekuestruara të pandehurit Behar Nuhiallari të cilat përshkruhen në procesverbalin “Për sekuestrimin e sendeve” mbajtur më datë 07.06.2024 ora 09:30 **t’i kthehen këtij të pandehuri.**

10) Sendet e sekuestruara të pandehurit Behar Rexha të cilat përshkruhen në procesverbalin “Për sekuestrimin e sendeve” mbajtur më datë 07.06.2024 ora 07:50 **t’i kthehen këtij të pandehuri.**

11) Sendet e sekuestruara të pandehurit Deila Qama të cilat përshkruhen në procesverbalin “Për sekuestrimin e sendeve” mbajtur më datë 07.06.2024 ora 07:30 **t’i kthehen kësaj të pandehure.**

12) Sendet e sekuestruara të pandehurit Arnold Shahu të cilat përshkruhen në procesverbalin “Për sekuestrimin e sendeve” mbajtur më datë 07.06.2024 ora 13:20 **t’i kthehen këtij të pandehuri.**

13) Sendet e sekuestruara të pandehurit Ylli Çaushaj të cilat përshkruhen në procesverbalin “Për sekuestrimin e sendeve” mbajtur më datë 07.06.2024 dhe në urdhrin “Për bashkimin e provave materiale me fashikullin gjyqësor” datë 31.07.2025, **ti kthehen këtij të pandehuri.**

14) Sendet e sekuestruara të pandehurit Artid Shtylla, konkretisht: i) 1 (një) armë gjahu çifte model Bajkal, ruse me numër *****, për të cilat nuk janë gjetur dokumente dhe nga kërkimet në databaset policore nuk ekziston e rregjistruar dhe 15 (pesëmbëdhjetë) copë fishekë armë gjahu të llojit Bajkal, **të konfiskohen dhe të kalojnë në favor të shtetit; ii)** sendet e tjera të cilat përshkruhen në procesverbalin “Për sekuestrimin e sendeve” mbajtur më datë 07.06.2024 ora 07:30 dhe në urdhrin “Për bashkimin e provave materiale me fashikullin gjyqësor” datë 31.07.2025, **ti kthehen këtij të pandehur.**

15) Sendet e sekuestruara të pandehurit Murat Gjuniku të cilat përshkruhen në procesverbalin “Për sekuestrimin e sendeve” mbajtur më datë 07.06.2024 ora 09:30 **t’i kthehen këtij të pandehuri.**

16) Sendet e sekuestruara të pandehurit Bardhyl Imeri, konkretisht: i) një armë gjahu e markës "SARSILMAZ IS870TM", me numër serial nr.***** me dy gryka e vendosur në një kllës prej materiali nailon me ngjyrë ushtarake, **të konfiskohet dhe të kalojnë në favor të shtetit; ii)** sendet e tjera të cilat përshkruhen në procesverbalin “Për sekuestrimin e sendeve” mbajtur më datë 07.06.2024 ora 11:00 dhe në urdhrin “Për bashkimin e provave materiale me fashikullin gjyqësor” datë 31.07.2025, **ti kthehen këtij të pandehur.**

17) Sendet e sekuestruara të pandehurit Bajram Xhaja të cilat përshkruhen në

procesverbalin “Për sekuestrimin e sendeve” mbajtur më datë 07.06.2024 ora 07:45 **t’i kthehen këtij të pandehuri.**

18) Sendet e sekuestruara të pandehurit Besnik Lumaj të cilat përshkruhen në procesverbalin “Për sekuestrimin e sendeve” mbajtur më datë 07.06.2024 ora 07:45 **t’i kthehen këtij të pandehuri;**

19) Sendet e sekuestruara të pandehurit Altin Neli të cilat përshkruhen në procesverbalin “Për sekuestrimin e sendeve” mbajtur më datë 07.06.2024 **t’i kthehen këtij të pandehuri.**

20) Sendet e sekuestruara të pandehurit Fatmir Stankova, konkretisht: i) telefoni celular i cili përshkruhet në procesverbalin “Për sekuestrimin e sendeve” mbajtur më datë 07.06.2024 ora 07:00 dhe në urdhrin “Për bashkimin e provave materiale me fashikullin gjyqësor” datë 31.07.2025, **ti kthehet këtij të pandehuri: ii)** Fotokopje kujtesë noteriale me Nr. **** Rep., dhe Nr. **** Kol., datë **** dhe Fotokopje Vërtetim njësie me origjinalin me Nr. **** Rep., datë ****, **të asgjesohen.**

21) Sendet e sekuestruara të pandehurit Arben Rushiti, konkretisht: i) telefoni celular i markës Samsung, me ngjyrë gold me IMEI: ****, një kartë me logon e kompanisë Vodafone gjendur brenda këtij telefoni me nr. Karte ****, si dhe një Laptop i markës “Dell Inspiron N5030”, me ngjyrë të zezë, **ti kthehet këtij të pandehuri; ii)** Fletore shënimesh ku në pjesën e sipërme gjendet mbishkrimi me emrin “shpenzimet” dhe vijon me data përkatëse të muajit Gusht dhe Shtator; shkresë me nr. **** prot. Datë ****; fotokopje diplome me nr. **** dhe fotokopje të pasqyrave të notave me numër fletësh 2, **të mbeten pjesë e dosjes; iii)** sendet e tjera të cilat përshkruhen në urdhrin “Për bashkimin e provave materiale me fashikullin gjyqësor” datë 31.07.2025, të cilat janë të **falsifikuara të asgjesohen.**

22) Sendet e sekuestruara të pandehurit Xhelil Alla, konkretisht: i) telefoni celular i përshkruar i cili përshkruhet në procesverbalin “Për sekuestrimin e sendeve” mbajtur më datë 07.06.2024 ora 07:59 dhe në urdhrin “Për bashkimin e provave materiale me fashikullin gjyqësor” datë 31.07.2025, **ti kthehet këtij të pandehuri: ii)** Printer i markës EPSON ngjyrë e zezë, me numër ****; printer markës EPSON ngjyrë e bardhë me numër ****; laptop i markës HP, ngjyrë e bardhë, me numër **** dhe printer pajisje laminator, model 5500, numër serial ****, **të konfiskohen dhe të kalojnë në favor të shtetit; iii)** sendet e tjera të cilat përshkruhen në urdhrin “Për bashkimin e provave materiale me fashikullin gjyqësor” datë 31.07.2025, të cilat janë të **falsifikuara të asgjesohen.**

23) Sendet e tjera të sekuestruara me të cilët kanë kryer veprimet agjentët e policisë, të cilat përshkruhen në procesverbalin “Për sekuestrimin e sendeve” mbajtur më datë 11.10.2023 ora 15:00 të cilat janë të **falsifikuara të asgjesohen.**

31. Shpenzimet proceduriale të bëra gjatë hetimeve paraprake dhe ato gjyqësore t’i ngarkohen të pandehurve të shpallur fajtorë, në mënyrë solidarë.

32. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmja e njoftimit të këtij vendimi.

Tiranë, më datë 03.08.2026

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar